



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARCHIVE
OUTPUT ARCHIVES
Nr. Inv/Br. Inv. 01-052101-23532
Data/Datum/Date 07.05.2025
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

DATA/DATUM/DATE:	07.05.2025
REFERENC/	05
PËR/ZA/TO:	Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini
CC:	Kryesuesja e Kuvendit Komunal znj. Arbnesha Kuqi
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
NGA/OD/FROM:	Adelina Shehu-Kola, Drejtoreshë Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Raport nga DSHMS

Te Nderuar,

Te bashkangjitur, gjeni Raportin e kërkuar për periudhën Janar-Prill 2025 nga Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



RAPORT PUNES NGA PERIUDHA JANAR-PRILL 2025 I DREJTORISE SE SHENDETESISIE DHE MIREQENIES SOCIALE.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale aktivitetin e vet e kryen përmes:

- Sektori për Shëndetësi
- Sektori për Mirëqenie Sociale
- Qendra për Punë Sociale
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
- Departamenti I Mjekesise Familjare:
- Sektori i Mjekësisë Familjare
- Njësia e SISH
- Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit
- Sektori i Shëndetit Oral dhe Preventiv
- Sektori i Kujdesit Urgjent
- Sektori konsultativ dhe Diagnostik
- Kabineti Radiologjik
- Laboratori

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale gjate periudhës Janar- Prill 2025 ka realizuar një numër te konsiderueshëm aktivitetesh dhe punësh, te cilat i ka pasur te planifikuara me Planin e Punës 2025.

Fillimisht është bere raportimi dhe vlerësimi i projekteve në proces, ato në përfundim, dhe të tjerat në vazhdimësi ne kuadër të përfundimit te vitit 2024 pranë DSHMS-së.

Është bërë organizimi i punës tek te varurit pranë kësaj drejtorie, duke ofruar udhëzime dhe monitorim i punës se Kujdesit Parësor Shëndetësor -së si dhe Qendrës për Pune Sociale.

DSHMS ka filluar dhe hartuar Planin orientues si Plan te Punës për vitin 2025.

Sa i përket aktiviteve tjera DSHMS ka filluar me procedurat për hartim te specifikacioneve me para masat dhe parallogarite për kontratat e planifikuara për këtë vit fiskal, duke parashtruar kërkesat tek Zyra e Kryetarit për marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me projektet ne investime kapitale, mallra dhe shërbime, shërbime shëndetësore dhe aktivitete tjera.

SUBVENCIONET DHE MBESHTETJA SOCIALE

Gjate kësaj periudhe nga data 03.02.2025-03.03.2025 është hapur Thirrje Publike për subvencionim në fushën e Shëndetësisë, ku janë pranuar aplikacionet për mbështetje financiare, dhe janë realizuar pagesat për këto kategori.

Nga total **301** aplikues janë përzgjedhur:

183- Aprovime

118- Refuzime,

Gjithsejtë shuma e parapare e mjeteve për Thirrjen Publike është **60,000.00**

- Nga data **03.03.2025- 24.03.2025** është hapur Thirrja Publike e Organizatave Jo Qeveritare.

Shuma e planifikuar për këtë Thirrje është **35,000.00** euro.

Subvencionet për OJQ-të janë në proces shqyrtimi dhe zbatimi.

- Janë ndarë subvencione në vlerë prej 150 euro për katër (4) familje strehuese.

Numri total i lendeve të cilat janë trajtuar në DSHMS është **465** gjithsejtë.

Nga muaji mars me datë **18.03.2025- deri me 18.04.2025** është hapur Thirrja publike për strehim të rasteve sociale në banesa sociale.

Në këtë periudhë raportuese në DSHMS janë pranuar gjithsejtë 139 kërkesa për strehim.

Te gjitha këto kërkesa akoma janë në proces të vlerësimit nga komisioni vlerësues.

- Kërkesa për pagesë të qerash 6
- Aprovime të qerash 3

Aktivitetet dhe ngjarjet publike

- Janë zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe edukative në kuadër të Ditëve Botërore të Shëndetit.
- Është organizuar dhe përcjelle procesi i imunizimit dhe vaksinimit në qendrat shëndetësore.

Bashkëpunime dhe trajnime

- Drejtoria ka marrë pjesë në trajnime dhe konferenca profesionale.
- Janë zhvilluar takime me përfaqësues të OJQ-ve partnere si UNICEF, AQH, Save the Children, etj., me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi në fuqi.

Marrëveshje institucionale

- Është vazhduar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komunës dhe Shoqatës “Bereqeti” për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive për familjet në nevojë.

Shërbime dhe vizita në terren

- Janë trajtuar raste sociale të referuara nga QPS, me fokus në mirëqenien e fëmijëve.
- Kanë filluar vizitat sistematike në shkolla për monitorim dhe promovim të shëndetit publik.
- Është në përgatitje hapja e shërbimit të Kujdesit Paliativ, për herë të parë në komunën tonë.
- Është duke u përcjellë implementimi i Planit për të Drejtat e Fëmijëve.
- Është aprovuar statuti i QKMF-së.
- Janë vizituar Qendrat e Mjekësisë Familjare për të monitoruar kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

**PROJEKTET,AKTIVITETET,SHËRBIMET DHE PUNET E
PLANIFIKUARA DHE TE KRYERA GJATE PERIUDHES
JANAR-PRILL 2025**

EMRI I PROJEKTIT	STATUSI I REALIZIMIT	VËREJTJE	TOTALI I VLERES
Furnizim me barna emergjente	Kontrata është lidhur me 01.02.2025	Kontrata përfundon 01.02.2027	42,791.14€
Furnizim me material stomatologjik	Kontrata është lidhur me 27.12.2024	Kontrata përfundon 26.12.2025	38,588.50 €
Asgjesimi i barnave dhe mbetjeve medicinale	Kontrata është lidhur me 13.02.2025	Kontrata përfundon 12.02.2028	49,223.00 €
Furnizim me letër	Kontrata është lidhur me 10.01.2025	Kontrata përfundon 09.01.2027	Kontrate e nga niveli qendror

KONTRATA PER SHERBIME

Mirëmbajtja e hapësirave te objektive te KPSH dhe QPS	Kontrata eshte lidhur me 13.06.2024	Kontrata përfundon 13.06.2026	360,00.00 €
---	-------------------------------------	-------------------------------	-------------

INVESTIMET KAPITALE-Planifikimet e bazuara ne buxhetin vjetor 2025

Riparimi dhe mirëmbajtja ne QKMF 1,QMF-Orize, QMF-Dardani dhe QMf-Erenik	Është realizuar 30.01.2025	Ne vazhdimësi	100,000.00 €
Bashkefinancim me AQH sipas marrëveshjes se Komunës			50,000.00 €

Renovimi i Banimit Social Ekzistues	Është realizuar 28.12.2023	Ne vazhdimësi	190,000.00 €
Ndërtimi i shtëpisë për personat te moshuar	Kontrata është nënshkruar 10.01.2024	Ne vazhdimësi	200,000.00 €
Ndërtimi i Banimit Social (faza e dyte)	Kontrata është nënshkruar 11.11.2024	Ne vazhdimësi	190,000.00 €

Raporti financiar i Dshms-se 01.01.2025 deri me 30.04.2025

Ne Raport është paraqitur Kujdesi Primar Shëndetësor, Administrata e DSHMse dhe Qendra për Pune Sociale

KUJDESI PRIMARE SHENDETESORE DHE ADMINISTRATA E DSHMS-se

Klasifikimi buxhetor	buxheti	alokimi	mbetja	shpenzimi	zotimi	mjetet e lira
PAGAT	3,896,672.00	1,872,582.21	2,024,089.79	1,244,496.50	-	628,085.71
M&SHERBIMET	640,693.00	640,693.00	-	168,195.78	37,326.59	435,170.63
SHP.KOMUNALE	80,000.00	80,000.00	-	32,045.32	3.00	47,951.68
SUBVENCIONET	130,000.00	106,071.00	23,929.00	59,900.50	-	46,170.50
KAPITALE	290,000.00	290,000.00	-	92,427.50	197,572.50	-
TOTALI	5,037,365.00	2,989,346.21	2,048,018.79	1,597,065.60	234,902.09	1,157,378.52

QENDRA PER PUNE SOCIALE 01.01.2025-30.04.2025

Klasifikimi buxhetor	buxheti	alokimi	mbetja	shpenzimi	zotimi	mjetet e lira
PAGAT	111,339.00	72,654.60	38,684.40	47,376.43	-	25,278.17
M&SHERBIMET	30,000.00	30,000.00	-	6,085.57	299.67	23,614.76
SHP.KOMUNALE	8,000.00	8,000.00	-	3,668.90	-	4,331.10
SUBVENCIONET	10,000.00	5,000.00	4,500.00	1,350.00	-	4,150.00
KAPITALE	190,000.00	190,000.00	-	99,998.20	90,001.80	-
TOTALI	349,339.00	306,154.60	43,184.40	158,479.10	90,301.47	57,374.03

Nga Evidentimi I te dhënave lidhur me të gjitha kategoritë e dalura nga luftërat (invalidët civil dhe të luftës për të zhdukur dhe të burgosur gjeni te bashkangjitur raportin e punës për periudhën kohore **janar-prill 2025**

Kërkesa nga Invalidë te luftës dhe kërkesa për Invalidë civil te Luftës	Numri i vërtetimeve te lëshuara
Lëshimi i vërtetimeve për viktima civile te luftës	28 aprovime
Lëshimi i vërtetimeve për Invalid Civil te luftës	16 aprovime
Lëshimi i vërtetimeve për Dëshmore te rene ne luftën e fundit	12 aprovime
Lëshimi i vërtetimeve për te burgosurit e luftës se fundit ne Kosove	9 aprovime
Lëshimi i librezave për njerëzit e prekur nga lufta e fundit, me te cilën lirohen nga shërbimet shëndetësore	27 aprovime
Nga Arkiva e DSHMS janë lëshuar dokumentacion për Invalid te Luftës te viteve 1956 e tutje	3 dokumente te aprovuara